



VENDIM

Nr. 2, Datë 19.01.2017

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E
MARRËVESHJES PËR PJESËMARRJEN NË TREGUN E ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; kapitullit II, pika II.2.4 të “Rregullave të përkohshme të tregut Shqiptar të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE; nr.139, datë 25.08.2016 , dhe nenit 26 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016”; Bordi i ERE në mbledhjen e tij të datës 19.01.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e “Draft marrëveshjes për Pjesëmarrjen në Tregun e energjisë elektrike”, të përgatitur nga Drejtoritë teknike,

Konstatoi se :

- Kjo Marrëveshje hartohet në zbatim të kapitullit II, pika II.2.4 të Rregullave të Përkohshme të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike të miratuara me vendim të Bordit të ERE nr.139, datë 25.08.2016 .
- Me shkresën nr. 6583 Prot., datë 18.10.2016, OST sh.a. ka dërguar në ERE kërkesën për miratimin e “Draft marrëveshjes për Pjesëmarrjen në Tregun e energjisë elektrike”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e “Draft marrëveshjes për Pjesëmarrjen në Tregun e energjisë elektrike”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Bordi



-
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OST sh.a. KESH sh.a, OSHEE sh.a, Autoritetin e Konkurrencës, MEI dhe palët e interesuara për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare

Kryetari i ERE
Petrit AHMETI